



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.67

Prishtinë, më 1.11.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Sërgjan Popoviq, Shukrije Bytyçi dhe Teuta Haxhiu.

Përfaqësues të ftuar: **Arsim Bajrami**, ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i Ministrit të Arsimit lidhur me kurrikulet dhe tekstet shkollore;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Raportim i Ministrit të Arsimit lidhur me kurrikulet dhe tekstet shkollore;

Nait Hasani tha se Komisioni në mbledhjen e kaluar ka kërkuar nga Ministri i MASHT-it që të raportojë para Komisionit në lidhje me tekstet shkollore dhe kurrikulet. Ka pasur ankesa nga mësues dhe profesorë

lidhur me plotësim-ndryshimet e kurrikulës bazë, kornizat e kurrikulës dhe një nga pyetjet kryesore ka qenë a do të kemi një kurrikulë dhe mos t'i themi kornizë.

Një çështje tjetër ka të bëjë me lëndët dhe plotësim- ndryshimet e tyre dhe fondi i orëve tek kurrikulet, ku është lënda e historisë dhe ajo e gjuhës shqipe. Këto janë kërkesat që i janë paraqitur Komisionit dhe është thënë se është zvogëluar fondi i orëve të gjuhës shqipe për shkak se është futur gjuha gjermane si gjuhë e dytë.

Ministri Arsim Bajrami, në fjalën e tij para Komisionit, prezantoi analizën dyvjeçare të punës dhe u shpreh mjaft i kënaqur më punën e bërë nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, duke e cilësuar si një ndër punët më të spikatura të MASHT-it gjatë dy viteve të fundit. Ai tha se kurrikula e re është tërësisht e bazuar në kompetenca dhe shkathësi. Më tej, Bajrami ai shtoi se kurrikula e hartuar nga institucionet e Kosovës, e tëra si e tillë është marrë si model edhe nga Shqipëria, duke theksuar se kjo kurrikulë është e hartuar me ndihmën dhe përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë, siç është GIZ-i, por edhe Bashkimi Evropian ka investuar shumë dhe në këtë mënyrë është trasuar rruga e implementimit të të gjitha komponentëve të kurrikulës deri në vitin 2021.

Osman Buleshkaj, njoftoi Komisionin në pika të shkurtra për përpjekjet që të angazhuarit kanë bërë në hartimin e kurrikulës dhe shtrirjen e saj në të gjithë vendin. Ai tha se nevoja për ndryshim të kurrikulës është prezantuar në vitin 2010, si orientim strategjik i Ministrisë për modifikim, avancim, ngritje të cilësisë në arsim në përgjithësi, sidomos në fushën e reformimit të kurrikuleve, të përmbajtjeve programore.

Më tej Buleshkaj prezantoi disa shtylla kryesore të cilat e karakterizojnë kurrikulën, duke thënë se e fundit që është shtuar është përfshirja e mësimit në diasporë dhe mërgatë, si pjesë e kornizës kurrikulare. Sipas tij korniza ka përcaktuar kompetencat, qëllimet si dhe parimet sipas të cilave udhëhiqet i gjithë procesi. Një përcaktim tjetër i dalë nga Korniza është fusha kurrikulare dhe lëndët mësimore, roli i shkollës dhe organeve drejtuese të saj si zbatues të kurrikulës si dhe orientimi për hartimin e materialeve të reja për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Ai tha se një risi në pakon e re të kurrikulës janë planet dhe programet mësimore për lëndë dhe klasë.

Një çështje tjetër e prezantuar ishte pilotimi i kurrikulës, ku mes tjerash u tha se vlerësimet e saj janë bërë përmes raporteve të ndryshme nga DKA-të, Projektit të Binjakëzimit, Institutit Pedagogjik si dhe Raportet e Divizionit të Planeve dhe programeve të teksteve shkollore. Baza për arsyeshmërinë e dokumenteve kurrikulare ka ardhur pas kërkesave të shkollave për planin mësimor, atë të përmbajtjes lëndore në nivel qendror, saktësimi i formave të vlerësimit, orientimi më i qartë në planifikim të përmbajtjeve si dhe vendimi politik për rishikim të dokumenteve kurrikulare.

Buleshkaj shtoi se gjatë rishikimit të dokumentit dhe hartimit të programeve lëndore, është bërë hartimi i programeve lëndore për klasët 0, 1, 6 dhe 10 si dhe janë rishikuar tekstet ekzistuese për klasët 1 deri 9.

Nait Hasani në vazhdim theksoi se gjatë takimit që kanë pasur me disa mësues, është thënë se në klasat e pesta dhe të nënta bëjnë vetëm përsëritje dhe si rrjedhojë e kësaj edhe pyetja e tij kishte të bënte me të rejtat që nxënësit mësojnë gjatë këtyre klasëve. Ai foli për fondin dhe ndarjen e orëve në gjimnazet gjuhësor dhe atë të shkencave natyrore, duke përfshi orët për gjeografi, gjuhë dhe letërsi, histori etj, duke pyetur sa a janë të mjaftueshme këto, gjithmonë duke iu referuar analizës së bërë nga hartuesit e kurrikulës së re.

Më tej, Hasani shtroi çështjen se a do të kemi një shtëpi të vetme botuese sepse nxënësit po kanë probleme se cilat libra të të cilave shtëpi botuese t'i konsultojnë dhe mësojnë.

Në përgjigjen e tij, Osman Buleshkaj theksoi se përcaktimi i fondit të orëve ka ardhur nga kërkesa që kanë parashtruar shkollat dhe në këtë mënyrë të kemi një fond të njëjtë të orëve në nivel vendi.

Në pyetjen se çfarë mësojnë të re nxënësit e klasëve 5 dhe 9, ai u përgjigj duke thënë se për këto klasë vazhdon të zbatohet kurrikula.

Shpejtim Bulliqi paraqiti nevojën e rishikimit e disa elementeve, duke thënë se ndonëse arsyeja për këtë është kjo kurrikulë, është në fazën e pilotimit dhe në këtë mënyrë të kemi mundësinë e mënjanimit dhe eliminimit të disa lëshimeve që mund të hasen gjatë pilotimit.

Bulliqi ngriti problematikën me lëndën e gjeografisë, duke thënë se gjeografia në pjesë e klasëve 6-9, ka mbetur në grupin “Shoqëria dhe Mjedisi”, kurse tek gjimnazet ka kaluar në pjesën e “Shkencat e Natyrës”. Ai tha se lënda e gjeografisë, tek fusha e “Shkencave të Natyrës” ka pasur më shumë subjektivizëm dhe se mbase është dashur që aty t’i kushtohet vëmendje më e madhe, ku problemi është te klasët 6-9, dhe se në klasët e 9-ta nuk mjafton një orë e vetme për të shtjelluar në mënyrë të duhur lëndën e gjeografisë.

Sa i përket gjimnazit, Bulliqi sugjeroi që të rishikohet lënda e astronomisë, duke theksuar se kjo lëndë është subjekti vizuar dhe ajo është kanalizuar kah Astrofizika. Ai shtoi se përveç kësaj është bërë një shkelje me udhëzimin administrativ që iu ka bërë gjeografit, ndonëse për astronomi më i thirrur është gjeografi sesa fizikani.

Nait Hasani shtroi pyetjen se në rast të ndërrimit të ministrit, a do të ketë nderime të kurrikuleve, përgjigjen e së cilës e morri nga ministri Arsim Bajrami, i cili tha se ai nuk ka pasur asnjë ndërhyrje dhe se krejt çka ka bërë ai, ka qenë përcaktimi i tri prioriteteve: të mos nxitohet me shtrirje, pa u bërë rishikimi dhe këtu vlen parimi “piloto, rishiko dhe zgjero”.

Ai theksoi edhe njëherë se ky projekt është bërë me partnerët e dy shteteve me sistemin më të mirë të arsimit, atë finlandez dhe austriak.

Ismajl Kurteshi pyeti për Marrëveshjen për unifikimin e kurrikulës në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe çfarë ka bërë MASHT-i që kjo të jetësohet. Pyetja tjetër kishte të bënte se a do të përdoret kjo kurrikulë edhe për komunitetet që jetojnë në Kosovë, dhe a ka ndërmarrë diçka për balancimin e planit mësimor, pasi që kjo del si vërejtje nga raporti vlerësues i një universiteti në Finlandë.

Kurteshi më tej foli edhe rreth trajnimit të mësimitdhënësve dhe përgatitjes së tyre, para se kjo kurrikulë të fillojë së zbatuari. Ai përmendi edhe monitorimin si një mangësi dhe çka është ndërmarrë në lidhje me këtë para se të fillojë implementimi i kurrikulës. Një shqetësim tjetër i ngritur nga Kurteshi ishte mungesa e teksteve mësimore adekuate sipas kurrikulës dhe mungesa e teksteve shkollore profesionale.

Më tej, ai paraqiti konstatimin e raportit vlerësues se mësimitdhënësit nuk kanë mbështetje të mjaftuar për t’u përgatitur dhe kërkoi sqarim se çfarë ka ndërmarrë Ministria që mësimitdhënësit të kenë mbështetjen adekuate për zbatimin e plotë të kurrikulës së re në të gjitha shkollat e Kosovës dhe se a janë gati shkollat për ta zbatuar këtë kurrikulë.

Zëvendësministri **Agim Bërdynaj**, iu përgjigj pyetjeve të Ismajl Kurteshit duke thënë se sa i përket marrëveshjes për unifikimin e kurrikulës në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, ajo është tërësisht e unifikuar dhe zbatohet në tërë sistemin arsimor të Shqipërisë. Sa i përket përgatitjes së mësimitdhënësve profesionalë, ai shtoi se ministria po bashkëpunon me shtetin austriak, të cilat janë të parët në këtë fushë.

Ministri Bajrami, sa i përket pyetjes se Kurteshit për shkollat serbe, ai tha se sipas Planit të Ahtisarit, ata kanë të drejt të marrin tekstet dhe programet shkollore të Serbisë, por pasi që për këtë të njoftohet MASHT-i. Ai tha se në rast se MASHT nuk pajtohet, atëherë Këshilli Vlerësues konstaton që asnjëra prej tyre nuk është në harmoni me kornizën ligjore.

Në lidhje me pyetjen për balancimin e planit mësimor, Osman Buleshkaj u përgjigj, duke thënë se ky plan është bërë pas rekomandimeve dhe sugjerimeve për balancim të fondit të orëve për klasë dhe niveleve të caktuara për të gjitha fushat. Ai tha se ky plan i ri paraqet një pasqyrë me të detajuar për balancim të planit mësimor.

Mufera Shidik pyeti rreth afateve kohore që ka paraparë ministria për këtë program, në mënyrë që të mos përsëritet i njëjti pas pak viteve si dhe si do ta implementojë ministria këtë kurrikulë edhe me komunitetet tjera në Kosovë.

Ministri Bajrami iu përgjigj duke thënë se ky është një proces i vazhdueshëm dhe që deri në vitin 2021 ky proces do të zbatohet. Ndërsa sa i përket pakicave tjera joserbe ato do të vazhdojnë të punojnë me kurrikulën e Kosovës.

Bekim Haxhiu në fjalën e tij tha se edhe më parë ka ngritur shqetësimin e tij lidhur me përmbajtjen e librave, sidomos atë të Historisë. Ai shprehu mendimin e tij që orientimet dhe përmbajtja në fushën e shkencave shoqërore duhet të jetë me e specifikuar, pasi që sipas tij ato orientime janë shumë të gjëra. Në vazhdim Haxhiu tha se është problematikë ulja e numrit të nxënësve dhe punësimi i mësimitdhënësve nëpër shkolla për arsye partiake. Ai pyeti ministrin se si do të veprojnë me uljen e numrit të nxënësve dhe sistemimin e mësimitdhënësve.

Rreth zvogëlimit të numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar, duke krahasuar statistikën e vitit të kaluar me këtë vit shkollor, atëherë kemi 5.100 nxënës më pak, por që si fond të orëve nuk e kemi zvogëluar për arsye se mbi bazën e strategjisë të sigurimit të cilësisë është paraparë që në shkolla të ketë koordinator të sigurimit të cilësisë, varësisht nga numri i nxënësve ekzistues dhe se ende nuk i ka ardhur radha për t'u rishikuar për shkak të fazave të shtrirjes.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës, nuk pat diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

Kryetari i Komisionit
Nait Hasani